



## KONTRATE THEMELIMI E ORTAKUT TE VETEM

Z. OMIR SHAHINI i biri i RAMAZAN-it, datelindja 26 10 1967 ,lindur ne Durres, banues ne Durres, i cili ra dakort si me poshte;

### NENI 1

Te krijoje shoqerine me perjegjesi te kufizuar me emrin “ALB SEA TRANSPORT” sh.p.k. me seli ne Durres me adresë : L 1 rruga Taulantia nr 1050.

### NENI 2

Shoqera “ALB SEA TRANSPORT” sh.p.k. eshte person juridik dhe vepron si e tillë qe nga dita e regjistrimit ne Gjykatën Tregtare (Rrethit) Tirane dhe qe nga momenti i paisjes me leje nga organet tatimore. Veprimitaria e saj rregullohet sipas neneve te kesaj kontrate, statutit bashkengjitur dhe legjislacionit shqiptar ne perjithesi.

### NENI 3

Veprimitaria e shoqerise “ALB SEA TRANSPORT” sh.p.k. eshte fiksuar per një periudhe kohe mbi 20 (njezet) vjecare, kohe e cila mund te zgjate me aprovin e ortakut te vetem qe perfaqeson kapitalin themeltar.

### NENI 4 Objekti i veprimitarise se shoqerise.

Shoqeria “ALB SEA TRANSPORT” sh.p.k. ka si objekt te veprimitarise se saj :

#### 1. Ne fushen e tregtise:

a – Import-eksport te mallrave industriale dhe elektro-shtepiake si TV, kompjuter, video, frigorifere, kondicionere, lavatrice, soba me gaz dhe korent, makina qepese, mikroonde, fshesa me korent etj.

b – Artikuj e mallra ushqimore si vaj, sheqer, oriz, makarona, konserva, piye alkoolike dhe freskuese

#### 2. Ne fushen e sherbimit :

Sherbime publike si transport detar te mallrave me anije, agjensi detare e spacionere bar-bufe, restorante,



## NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise "ALB SEA TRANSPORT" sh.p.k. perbehet nga kontribut ne para.

Kapitali themeltar i shoqerise "ALB SEA TRANSPORT" sh.p.k. eshte 100.000 (njeqindmije) leke.

Ky kapital eshte i ndare ne 100 (njeqind) pjese nominative 1.000 (njemije) leke

Kuota e themeluesit, pronaro e ortakut te vetem te shoqerise "ALB SEA TRANSPORT" sh.p.k. me kapital themeltar eshte 100%.

Derdha e kapitalit themeltar ne shumat e parashikuara me siper eshte bere prane Bankes Kombetare Tregtare Durrës

## NENI 6

Ne librin e shoqerise krijohet fondi themeltar i shoqerise, ku regjistrohen kapitalet (kontributet) e derdhura nga ortaku i vetem. Ortaku nuk kufizohet ne rritjen e kontributit te tij me fitimet qe rrjedhin nga veprimitaria e shoqerise. Menyra e rritjes se kapitalit themeltar te ortakut te vetem, percaktohet ne menyre te detauar ne Statusin bashkengjitur kesaj kontrate.

## NENI 7

Shoqeria ka te drejte te hape dege apo agjensi, filiale ne rrethe te tjera.

Shoqeria ka te drejten e zgjerimit te aktivitetit, ne bashkepunim me firma e shoqeri te tjera si dhe ka te drejten e ushtrimit te aktivitetit te mesiperm brenda e jashte vendit.

## NENI 8

Shoqeria ka te drejte te kete llogari ne leke dhe ne valute , ne bankat shqiptare dhe ne ato te huaja, ne perputhje me legjislacionin shqiptar, dhe ka te drejte te disponoje lirshem monetare te grumbulluara ne to.

## NENI 9

Fitimi i realizuar nga shoqeria , pasi shlyen detyrimet ndaj te treteve , pasi zbriten fondet e detyruara dhe pasi likuidohen taksat ne masen e percaktuar nga legjislacioni shqiptar, pra fitimi neto i realizuar i kalon i gjithi ortakut te vetem .

Humbjet qe mund te rezultojne gjate aktivitetit ekonomik te shoqerise , do te perballohen ne masen 100% nga ortaku i vetem i shoqerise z. **OMIR SHAHINI**

Fitimi i realizuar nga ortaku i vetem z. **OMIR SHAHINI**ne kuadrin e kesaj shoqerie , mund te transferohen lirshem jashtet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

## NENI 10

Administrator i shoqerise "ALB SEA TRANSPORT" eshte z. **OMIR SHAHINI**





## NENI 11

Ortaku i vetem themelues eshte perjegjes kundrejt te tretave per pasojat dhe demet qe rrjedhin nga anullimi ose deklarimi i pavlefshem i aktit te themelimit te shoqerise.

## NENI 12

Problemet e kapitalit themeltar dhe te pjeseve nominative , transferimi i kapitalit , zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit me ane te kontributeve , menyra e administrimit te shoqerise , emerimi i administratoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar, kopetencat dhe perjegjesite e tyre , menyra e mbajtjes se llogarive , asambleja dhe keshilli administrativ, falimentimi dhe humbje ½ se kapitalit themeltar, shndrimi i shoqerise dhe zgjidhja e mosmarreveshjeve si dhe probleme te tjera , percaktohen me me hollesi ne statutin e shoqerise “ ALB SEA TRANSPORT”sh.p.k. Statuti i bashkengjitet kesaj kontrate dhe eshte pjese perberese e saj.

## NENI 13

Kontrata pasi perpilohet, lexohet ne prezence te ortakut te vetem te shoqerise “ALB SEA TRANSPORT” sh.p.k. pasi aty gjendet i shprehur vullneti i tij I lire , nenshkruhet nga ai vullnetarisht.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE “ ALB SEA TRANSPORT” SH.P.K.  
OMIR SHAHINI**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE DURRES  
Nr 1507-Koleks Nr 221 Rep**

### VERTETIM

Sot me Durres date 11.04. 1999 diten e presente para meje **BUJAR TROCI** noter publik ne Durres u paraqit personalisht z. **OMIR SHAHINI** i datelindjes 26.10.1967,lindur ne Durres, I njojur personalisht prej meje,me zotesi te plete proceduriale per identitetin e te cilit u sigurova nga pat. me nr. Z 0329384, i cili para meje nenshkroi kete kontrate themelimi te ortakut te vetem.

Une noteri vertetoj \_\_\_\_\_

**NOTER  
BUJAR TROCI**

# STATUTI I SHOQERISE "ALB SEA TRANSPORT" sh.p.k.



Themeluesi deklaron se ka krijuar shoqerine me perjegjesi te kufizuar me emrin "ALB SEA TRANSPORT" sh.p.k.

## KREU I

### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

#### NENI 1

Themelues, pronar dhe ortak i shoqerise "ALB SEA TRANSPORT" sh.p.k. eshte **OMIR RAMAZAN SHAHINI**, i lindur me 26.10.1967 ne Durrës, banues ne Durrës

#### NENI 2

Shoqeria "ALB SEA TRANSPORT" sh.p.k. krijohet si person juridik shqiptar dhe vepron si e tille qe nga momenti i rregjistrimit ne Gjykatën Tregtare ( Rrethit ) Tirane dhe qe nga momenti i pajisjes me leje nga organet tatumore. Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij Statuti, kontrates bashkengjitur dhe legjislacionit shqiptar ne perjithesi.

#### NENI 3

Selia e shoqerise "ALB SEA TRANSPORT" sh.p.k. eshte ne Republiken e Shqiperise, ne qytetin e Durrësit , me adresë L 1 Rruga Taulantia nr 1050. Shoqeria mund te krijoje dege , perfaqesi ose agjensi te tjera ne Republiken e Shqiperise ose jashtë saj. Gjithashtu shoqeria ka te drejte te zgjeroje aktivitetin ne bashkepunim me firma e shoqeri te tjera.

#### NENI 4

Shoqeria ka vulen e saj me forme drejtendore.

#### NENI 5

Veprimtaria e shoqerise eshte e fiksuar per nje periudhe kohe mbi 20 (njezet ) vjecare kohe e cila mund te zgjatet me aprovimin e ortakut te vetem qe perfaqeson te gjithe kapitalin e themeltar.

#### NENI 6

#### Objekti i veprimtarise

Shoqeria "ALB SEA TRANSPORT" sh.p.k. ka si objekt te veprimtarise se saj :

## **1. Ne fushen e tregtise:**

- a. Import – eksport te mallrave industriale dhe elektro-shtepiake si Tv, kompjuter, video, frigorifere, kondicionere, lavatrice, soba me gaz e korent, makina qepese, mikroonde, fshesa me korent etj.
- b. Artikuj e mallra ushqimor si vaj, sheqer, oriz, makarona, konserva, pije alkoolike dhe freskuese

## **2. Ne fushen e sherbimit :**

Sherbime publikes transport detar te mallrave me anije ,brenda e jashte vendit, agjensi detare e spacionere ,bar-bufe, restorante.

## **KREU II Kapitali themeltar dhe kuota**

### **NENI 7**

Kapitali themeltar i shoqerise “ **ALB SEA TRANSPORT**“ sh.p.k. perbehet vetem nga kontribute ne para .

Kapitali themeltar i shoqerise “ **ALB SEA TRANSPORT**” sh.p.k. eshte 100.000 ( njeqindmije ) leke.

Ky kapital eshte i ndare ne 100 ( njeqind ) pjese, secila me vlere nominative 1.000 ( njemije ) leke .

Kontributi i ortakut te vetem ne kapitalin themeltar te shoqerise “ **ALB SEA TRANSPORT**” sh.p.k. eshte 100.000.( njeqind mijë) leke.

Kuota ne perqindje e ortakut te vetem ne kapitalin themeltar te shoqerise : “ **ALB SEA TRANSPORT**” sh.p.k. eshte 100 % .

Derdhja e kapitalit themeltar ne shumat e parashikuara me siper , eshte bere prane Bankes Kombetare Durrës.

## **KREU III Transferimi i pjeseve nominative te kapitalit themeltar**

### **NENI 8**

Pjeset nominative te kapitalit themeltar, jane lirisht te transferueshme , ne rast ndarjeje pasurore midis bashkeshorteve ne rruge trashegimie tek pasardhesit dhe paraardhesit si dhe tek te tretet.

Transferimi i pjeseve nominative te kapitalit themeltar, behet me miratimin e asamblese qe perfaqeshet nga themeluesi, pronari dhe ortaku i vetem i shoqerise “ **ALB SEA TRANSPORT**” sh.p.k. z. OMIR SHAHINI, i cili perfaqeson te gjitha pjeset nominative te kapitalit themeltar te shoqerise

Ne te gjitha rastet e transferimit cmimi i pjeseve nominative te kapitalit themeltar , do te caktohet sipas vlerave aktuale te bilancit te shoqerise ne momentin qe do te behet transferimi.



## KREU IV Administrimi dhe drejtimi I shoqerise

### NENI 9

Ne shoqerine "ALB SEA TRANSPORT" sh.p.k. ortaku i vetem z. **OMIR SHAHINI** eshte njekohesish t dhe **administrator i shoqerise**.

Ne funksion te aktivitetit qe kryen shoqeria ka te drejte te caktoje edhe administratore te tjere, qe mund te jene persona vendas ose te huaj.

### NENI 10 Kopetencat e administratoreve

Administratoret ( nese do te emerohen te tille ) kane kopetenca te plota per te vepruar ne cdo rrethane ne emer te shoqerise.

Administratoret i ushtrojne kopetencat e tyre brenda objektivit te veprimtarise te shoqerise, por kufizohen nga ato kopetenca qe ligji ia jep shprehimisht asamblese te ortakeve.

Administratoret perfaqesojne shoqerine para te treteve , ne gjykata , arbitrazhe, disponojne pasurite dhe interesat e saj me perjashtim te kopetencave qe u takojne organeve te tjera te shoqerise.

Administratoret raportojne per veprimtarine e tyre dhe perqigjen para ortakut te vetem per realizimin e detyrave dhe angazhime qe mbulojne dhe kane ne kopetence.

### NENI 11

#### Marreveshjet e ndaluara

Administratorit te emeruar nga ortaku i vetem nuk i lejohet te kontaktoje ne cfare do menyre qofte, te marre hua tek shoqeria te jepin pelqimin ne emer te saj per paradenie , si dhe te behen dorezenes apo te garantojne ne emer te saj ( shoqerise ) angazhimet ndaj te treteve. Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefsdhme .Kjo mase zbatohet edhe ndaj perfaqesuesve ligjore te ortakut te vetem , ndaj bashkeshorteve, paraardhesve dhe pasardhesve dhe ndaj cdo personi ndermjetes.

### NENI 12 Pergjegjesite ligjore te administratoreve

Administratoret jane pergjegjes individualisht ose solidarisht sipas rastit, ndaj shoqerise ose te treteve , per shkeljet ligjore te Statutit apo faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Klauzolat e Statutit qe kufizojne kopetencat e administratoreve duhet te respektohen nga te tretet. Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve, kur provon se te tretet e dini se akti i administratorit i kalon kopetencat e tij, apo objektin e veprimtarise te shoqerise.



Pasojat e marreveshjeve te pa miratuara qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohem administratorit qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose gjordarish sipes rastit, pasojat perkatese.

Rregullat e ketij nenii nuk zbatohen per marreveshjet qe behen per operacionet e perditshme dhe te kryera ne kushte normale.

### NENI 13

Ortaku i vetem ka te drejte qe pervec padise civile per shperblimin e demit te ngreje padi penale kunder administratoreve kur ekzistojne motivet.

### NENI 14 Shkarkimi I administratoreve

Administratoret shkarkohen me vendim te ortakut te vetem qe perfaqeson te gjithe kapitalin themeltar , si dhe nga gjykata.

### KREU V Asambleja e ortakeve

### NENI 15

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimor i shoqerise.. Vendimet qe merren nga asambleja protokollohen.

Ne shoqerine “**ALB SEA TRANSPORT**” sh.p.k. ne kushtet e ortakut te vtm me kuote 100 % asambleja perbehet vetem nga z. **Omir Shahini** , i cili zoteron 100 % te votave.

### NENI 16 Kopetencat e asamblese

Asambleja e ortakeve ka te drejte te kryeje ne cdo kohe verifikimin dhe kontolle qe ajo i shikon te arsyeshme dhe kerkon te njihet ne cdó kohe me dokumentat qe ajo i gjykon te arsyeshme per plotesimin e detyres te saj .

Asambleja e ortakeve emeron dhe shkarkon administratoret, keshillin administrativ, eksperte kontabel te autorizuar dhe cakton kopetencat, sektoret qe do te mbulojne dhe angazhimet etyre.

Asambleja merr vendime per transferimin e kapitalit , sipas procedures te percaktuar ne nenin 8 ( tete ) te Statutit.

Merr vendime per zgjatjen e afatit te veprimtarise se shoqerise, ose per zgjerimin e objektit te veprimtarise se saj , per zmadhimin ose zvogelimin e kapitali themeltar.

Merr vendime per ndryshimin e tipit te shoqerise ne varesi te kapitalit themeltar te shoqerise.





Me kuvendime per ndryshimin e Statutit ose plotesimin e tij ne rastet kur ajo (asambleja) e cmon te arsyeshme dhe ne vartesi nte ndryshimeve te legjislacionit shqiptar

**NENI 17  
Ndryshimet e statutit**

Ndryshimet e Statutit dhe te Aktit Themeltar vendosen nga asambleja qe perbehet nga ortaku i vetem me kuote 100 % kur e shikon te arsyeshme ky i fundit si dhe kur ndryshimi i statutit perben domosdoshmeri ligjore per funzionimin e shoqerise .

**NENI 18  
Zmadhimi I kapitalit themeltar**

Zmadhimi i kapitalit themeltar behet me vendim te asamblese se ortakeve,pasi ortaku i vetem ne menyre individuale ka deklaruuar, ka nenshkruar dhe ka shlyer (derdhur) pjeset e kapitalit qe do te zmadhohet, ne formen e kontributeve ne natyre ose ne para.

Zmadhimi I kapitalit themeltar nuk perfaqeson kontribute ne sherbime.

Ne cdo rast, zmadhimi i kapitalit themeltar shoqerohet me nje vendim asambleje per ndryshime ne Aktin e Themelimit dhe ne Statut, ku percaktohet shprehimisht pjesemarrrja e ortakut te vetem ne kapitalin themeltar te zmadhuar si dhe kuote e re.

**NENI 19  
Zvogelimi i kapitalit themeltar**

Zvogelimi i kapitalit themeltar behet me vendim te asamblese se ortakeve.

Zvogelimi i kapitalit themeltar e prek ortakun e vetem ne ate mase, sa jane pjeset e kapitalit qe ai perfaqeson.

Kur asambleja merr vendim per zvogelimin e kapitalit themeltar (qe motivohet nga humbjet e rezultuara te shoqerise ) nen limitin e parashikuara ne Kodin Tregtar te Shqiperise per sh.p.k., atehere ky vendim do te shoqerohet me keto veprime:

- 1 . Ndryshimi i tipit te shoqerise
- 2 . Ndryshimi i Statutit.
- 3 . Publikimi dhe njoftimi i te treteve me te cileve eshte dhene para dates se publikimit te ndryshimeve perkatese ne Statut mund te kundershtojne zvogelimin e kapitalit brenda 1(nje) muaji nga data ne rruge gjyquesore.

Kur asambleja e ortakeve miraton nje projekt- vendim per zvogelimin e kapitalit themeltar, qe nuk motivohet nga humbjet, kreditoret,kredia e te cileve eshte dhene para dates se publikimit te ndryshimeve perkatese ne Statut mund te kundershtojne zvogelimin e kapitalit brenda 1(nje) muaji nga data ne rruge gjyquesore.



**NENI 20**  
**Eksperti kontabel i autorizuar**  
**Emerimi dhe shkarkimi**

Emertimi i ekspertit kontabel te autorizur ne shoqerine "ALB SEA TRANSPORT" sh.p.k. eshte i detyrueshem , kur ne mbyllje te vitit finanziar , tejkalojen dy nga treguesit e meposhtem :

1. Totali i bilancit ne mbyllje te vitit perkates : 6.000.000 ( gjashtemilion ) leke
2. Totali i te ardhura vjetore 12.000.000( dymbedhjetemilion )
3. Numri mesatar i te punesuarve 10 ( dhjete ) vete.

Shqyrtimet e bera pa percaktuar espert kontabel te autorizuar ne rastet e detyruara me ligj si dhe raportet e eksperteve kontabel te autorizuar, te emeruar ne kundershtim me rregullat e parashikuara nga nenet 168 te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 " Per shoquerite tregatre " , jane te pavlefshme.

Ekspertet kontabel te autorizuar emerohen per nje periudhe 6 ( gjashte ) vitesh financiare, ne qofte se asambleja e ortakeve nuk merr vendim per shkarkimin e tij para mbarimit te mandatit .

Ne rast gabimi ose pengimi , eksperti kontabl i autorizuar mund te shkarkohet nga funksionet e tij me vendim te asamblese te ortakeve si dhe me vendim te gjykates.

**Detyrat e ekspertit kontabel te autorizuar**

Garanton qe llogarite vjetore jane te rregullta dhe te hartuara me sinqueritet konform ligjeve.

Pasqyron rezultatet e operacioneve te vitit te kaluar finanziar dhe gjendjen financiare te trashegimise te shoqerise ne fund te ketij viti.

Verifikon librat e llogarive dhe fondet e shoqerise dhe kontrollon pershtatjen e kontabilitetit te saj me legjislacionin ne fuqi.

Verifikon perputhjen me llogarine vjetore te informacione te dhena nga administratoret perpara asamblese se ortakeve, si dhe dokumentantat mbi gjendjen financiare qe jane paraqitur kesaj te fundit .

Eksperti kontabel i autorizuar eshte i detyruar ti beje te njojur administratoreve dhe asamblese se ortakeve :

- a. Kontrolllet dhe verifikimet qe kane kryer dhe sondazhet qe kane bere;
- b. Pjeset e bilancit dhe te dokumentave te tjera te kontabilitetit qe duhen ndryshuar dhe sygjerojne medodat per perpilimin e ketyreve dokumentave;
- c. Parregullsите dhe pasaktesite qe kane zbuluar;
- d. Perfundimet qe rrjedhin nga korrigimi i pasaktesive te mesiperme , mbi rrezultatet financiare te shoqerise.

Eksperti kontabel i autorizuar thirret ne te gjitha mbledhjet e asamblese se ortakeve qe mbyllin llogarite e vitit finanziar te perfunduar si dhe sa here e kerkon asambleja .



### Pergjegjesite ligjore te ekspertit kontabel

Eksperti kontabel i autorizuar eshte perjegjes ndaj shoqerise dhe ndaj te treteve per pasojat e demshme qe rrjedhin nga fajet dhe nenvlefsimet ne ushtrimin e funksionit te tij, por nuk jane perjegjes per shkeljet ligjore te kryera nga administratoret , me perjashtim te rasteve kur kane pasur dijeni per to, por nuk kane zbuluar dhe raportuar ne mbledhjet e asamblese.

Honoraret e ekspertit kontabel.

Honoraret e ekspertit kontabel te autorizuar paguhen nga shoqeria.

### NENI 21

#### Shnderimi I shoqerise

Shnderimi i shoqerise “ **ALB SEA TRANSPORT** ” sh.p.k. ne nje shoqeri kolektive apo komandite behet me vendim unanim te asamblese se ortakeve.

Ky shnderrim eshte i detyrushem per shoqerine , kur kapitali themeltar bie nen limitin e domosmoshem per sh.p.k.- t., limit ky i percaktuar ne Kodin Tregtar Shqiptar.

### NENI 22

Shnderimi i shoqerise “ **ALB SEA TRANSPORT** ” sh.p.k. ne shoqeri anonime behet me vendim te asamblese te ortakeve duke aplikuar rregullat mbi ndryshimet e Statutit ( neni 17 I ketij statuti ), me kusht qe paraprakisht te jete hartuar e aprovuuar nga asambleja bilanci i dy viteve te fundit te aktivitetit te shoqerise.

Para marrjes se vendimit per shnderrimin ne shoqeri anonime, asambleja eshte e detyruar te caktoje nje ekspert kontabel te autorizuar , per perqatitjen e raportit mbi gjendjen e shoqerise.

Cdo shnderrim ne kundershtim me rregullat e ketij neni eshte i pavlefshem.

### KREU VI

#### Rezervat e domosdoshme, shperndarja e fitimit , dividentet

### NENI 23

#### Rezerva e domosdoshme

Shoqeria “ **ALB SEA TRANSPORT** ” sh.p.k nga fitimi i rezervuar gjate vtit finanziar , pasi jane zbritur humbjet e vtitit te meparshem, eshte e detyruar te lere me menjane nje shume me vlore te pakten 1/20 e tij ( fitimit ) , e cila destinohet per formimin e nje fondi rezevre, te quajtur “ **REZERVE E DOMOSDOSHME** ” . Dispozita e mesiperme nuk eshte me e detyrueshme kur rezerva e domosdoshme arrin 1/10 e kapitalit themeltar.



## NENI 24

### Shperndarja e fitimit

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i vtit financiar, nga llicili eshte zbritur "Rezerva e domosdoshme" sipas nenit 23 te Statutit dhe nga ana tjeter jane zbritur ose shtuar humbjet apo fitimet nga vitet e meparshme.

Asambleja mund te marre vendim per shperndarjen e shumave te lena menjiane per rezerven, me kusht qe te mos preket "Rezera e domosdoshme" ne masan e parashikuar ne nenin 23 te Statutit. Vendimi tregon shprehimi i llojin e rezerves ku jane marre keto shuma.

Pervec rasteve te zvogelimit te kapitalit themeltar, asnje shperndarje nuk mund te behet ortaku i vetem, neqoftese kapitalet e tij jane ose do te beheshin mbas kesaj shperndarje, me te vogla se shumat e kapitalit themeltar plus "Rezerven e domozdoshme" te percaktuar ne Statut.

## NENI 25

### Percaktimi I dividenteve

Mbas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te shumes qe do te shperndahet, asambleja percakton pjesen qe i takon ortakut te vetem ne forme dividenti (Ndarja e fitimit ne raport me kuoten qe zoteron ortaku i vetem).

Shoqeria ka te drejte te jape edhe paradhenie, vlera e te cilave ka rrjedhur nga vitet financiare te mbyllura ose ne vazhdim, vlera keto te derdhura para mbyllijs se viti financiar, me kusht qe:

- a. Te mos preket "Rezerva e domosdoshme"
- b. Shuma qe ka depozituar shoqeria si rezerve, te jete te pakten e barabarte me paradheniet e shperndare.
- c. Te perpilohet nje raport nga eksperti kontabel i cili konfirmon se fitemet neto te realizuara deri ne ato kohe jane me te medha se paradheniet e shperndara.

Shperndarja e paradhenieve vendoset nga asambleja ose administratoret. Ne vendim percaktohet shuma dhe data e kthimit.

## KREU VII

### Pavlefshmerite dhe prishja e shoqerise

## NENI 26

Rastet e pavlefshmerise e shoqerise "ALB SEA TRANSPORT" sh.p.k. (Aktit te themelimit ose Statutit ) si dhe pavlefshmeria e akteve te tjera te saj ( vendimeve te asamblese, raporteve te ekspertit kontabel te autorizuar , vendimeve te administratoreve, etj ) mund te rezultojne vetem nga shkelja e nje dispozite urdheruese apo ndaluese te ligjt Nr. 7638 , date 19.11.1992 , ose e ligjshmerise ne fuqi per kontratat dhe veprimet juridike te parashikuara ne Kodin Civil.

  
Pavlefshmeria e shoqerise "ALB SEA TRANSPORT" sh.p.k. shpallet nga  
asambleja e ortakeve te shoqerise, vetem ne rastet e parashikuara ne nenet e  
poshteshenura

Shoqeria "ALB SEA TRANSPORT" sh.p.k. prishet automatikisht me perfundimin  
e afatit te parashikuar ne Kontraten e Themelimit dhe ne Statutin , ne qofte se ortaku i  
vetem nuk merr vendim per zgjatjen e afatit te veprimitarise se shoqerise.

**NENI 28**  
**Prishja per humbje e  $\frac{1}{2}$  se kapitalit themeltar**

Ne rast se kapitalet e shoqerise "ALB SEA TRANSPORT" sh.p.k. per shkak te  
humbjeve te konstatuara ne dokumentat financiare , rezultojne me te vogla se  $\frac{1}{2}$  ( gjysma )  
e kapitalit themeltar , ortaku i vetem brenda 4 ( kater ) muajve nga konstatimi i kesaj  
gjendjeje, vendos per mundesine e prishjes se shoqerise.

Ne rast se nuk shpallet prishja , shoqeria detyrohet te zvogeloje kapitalin themeltar  
me nje vlera jo me te vogel se vlera e humbjeve te pambaruara nga rezervat duke patur  
parasysh edhe limitin e parashikuar nga Kodi Tregtar per sh.p.k..

Ky operacion duhet te kryhet brenda vitit finanziar.

**NENI 29**  
**Prishja per shkak falimentimi**

Ne rast se Gjykata kopetente ( Gjykata e Rrethit Durres ) merr vendim per fillimin e  
procedures se falimentimit per shoqerine "ALB SEA TRANSPORT" sh.p.k. ,  
automatikisht kjo shoqeri konsiderohet e prishur dhe e gjithe pasuria e saj i dorezohet  
administratorit te falimentimit , per te filluar proceduren e falimentimit sipas kerkesave te  
ligjit Nr. 8017 ,date 25.10.1995.

**NENI 30**  
**Likuidimi**

Ne te gjitha rastet kur me vendim gjykate te formes te prere shpallet pavlefshmeria  
absolute ose relative e shoqerise "ALB SEA TRANSPORT" sh.p.k. , si dhe ne rastet kur  
asambleja merr vendim per prishjen e shoqerise ( ne rastet e parashikuara ne Statut ) fillon  
procesi i likuidimit te shoqerise "ALB SEA TRANSPORT" sh.p.k. proces i cili do te  
kryhet sipas kerkesave te parashikuara ne Kodin Tregtar Shqiptar.

**NENI 31**

Ky statut perpilohet ne 4(kater) kopje , lexohet ne prezence te ortakut te vetem dhe  
pasi aty gjendet i shprehur vullneti i tij i lire, nenshkruehet nga ai vullnetarisht .

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE " ALB SEA TRANSPORT"SH.P.K.DURRES**  
**NENSHKRIMI**  
**OMIR SHAHINI**

